



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 60/01-6695/24
Kaçanik, 29.03.2024

Në bazë të nenit 57.1 dhe 57.2 të Rregullores 01Nr. 7864/08 për Punë të Kuvendit të Komunës e datës 13.11.2008, në çështjen e shqyrtimit të Raportit të Punës së Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2023, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e vet të mbajtur më datë 29 mars 2024, mori këtë:

VENDIM
PËR APROVIMIN E RAPORTIT TË PUNËS I KOMITETIT
PËR POLITIKË DHE FINANCA PËR VITIN 2023

1. Me këtë Vendim, Aprovohet Raporti 01Nr. 60/01-6695/24 - me tekstin e mëtejme, Raport Pune i Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2023.
2. Raporti si në pikën 1 të këtij Vendimi përmban, pikësynimet në lidhje me realizimin e detyrave nga fushë-veprimtaritë që janë në kompetencë të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe nivelin e realizimit të tyre lidhur me aktivitetin e zhvilluar për gjatë vitit 2023.
3. Raporti është përmbledhur në gjithsej 8 faqe dhe i njëjti është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi sipas nenit 17 të Rregullores (MAPL) Nr.01/2017- për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës.

Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës; Komiteti për Politikë dhe Financa; Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli



Makfire Malsiu

From: Vjosa Ahmetaj
Sent: Wednesday, April 17, 2024 11:22 AM
To: Kemajl Murseli
Cc: Erblin Hetemi; Xhevat Tafa; Makfire Malsiu
Subject: Njoftim....

I nderuar,

Bazuar në Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, (shtojca II - Aktet e organeve të komunës që nuk i nënshtrohen shqyrtimit të detyrueshëm apo të rregullt të ligjshmërisë), Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal pas shqyrtimit të përmbajtjes së akteve të Komunës së Kaçanikut, si në vijim:

- Vendimi 01Nr. 60/01-6695/24 për aprovimin e raportit të punës së Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2023, vendim i datës 29.03.2024, vlerëson se akti i komunës nuk i nënshtrohet shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të Komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.

Me respekt,
Vjosa Ahmetaj
Zyrtare e Lartë për Monitorim të Komunave
Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave – MAPL
Tel: 038 200 64 144
E-mail: vjosa.ahmetaj@rks-gov.net
Adresa: Pallati i Shtypit Ish-Rilindja